

## Vendim nr. 198 datë 24.09.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim, anëtarë, në datën 24.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (Sh) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **SHOQATA E SIPËRMARRËSVE ITALIANË NË SHQIPËRI – A.I.I.A. (OJQ)**, përfaqësuar nga avokat Lulzim Alushaj, me prokurë.  
**DHOMA KOMBËTARE E NDËRMJETËSVE**, përfaqësuar nga avokat Lulzim Alushaj, me prokurë.  
**NJË GRUP PROFESIONISTËSH TË LIRË**, përfaqësuar nga avokat Lulzim Alushaj, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i neneve 12, pika 1, 24, pika 2 dhe 69, pika 1, shkronjat “dh” dhe “ë”, të ligjit nr. 29/2023, datë 30.03.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, si dhe nenit 4 të vendimit nr. 753, datë 20.12.2023 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, si të papajftueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.  
Pezullimi i efekteve të neneve 12, pika 1, 24, pika 2 dhe 69, pika 1, shkronjat “dh” dhe “ë”, të ligjit nr. 29/2023, datë 30.03.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, si dhe nenit 4 të vendimit nr. 753, datë 20.12.2023 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 11, 15, 17, 18, 41, 42, 49, 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “f”, 134, pikat 1, shkronjat “h” dhe “i”, dhe 2, 142 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i

**Protokollit nr. 1 të saj; nenet 27, 45, 49, pika 3, shkronjat “d” dhe “e”, 50, pikat 1 dhe 4, 71, 71/a, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 29/2023, datë 30.03.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” (*ligji nr. 29/2023*), i cili ka pësuar disa ndryshime me aktet normative nr. 2, datë 07.06.2023 dhe nr. 7, datë 14.12.2023. Në zbatim të nenit 70, pika 1, të këtij ligji, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 753, datë 20.12.2023 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar” (*VKM nr. 753/2023*), i cili në nenin 4 ka përcaktuar listën e shërbimeve me objekt tatimi nga data 1 janar 2024.

2. Në datën 19.04.2024 kërkesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit, e cila, pasi është plotësuar, është regjistruar në datën 24.04.2024. Me vendimin e datës 10.06.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 26.06.2024, bazuar në nenin 19, pika 3, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, ka vendosur pezullimin e shqyrtimit paraprak të kërkesës, me arsyetimin se çështja në fjalë ka në objektin e saj dispozita të të njëjtit ligj dhe të së njëjtës VKM, si dhe pretendime të ngjashme me një çështje, e cila në ato momente ishte në fazën e gjykimit në seancë plenare.

3. Konkretisht, në datat 18 dhe 25 qershor 2024, Gjykata ka marrë në shqyrtim kërkesën e 4 subjekteve, jo më pak se një të pestës së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë (37 deputetë), shoqatave “Instituti i Kontabilistëve të Miratuar” dhe “Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar”, si dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, me objekt: “*Shfuqizimi i neneve 24, pika 2 dhe 69, pika 1, shkronja “dh”, fjalia e dytë dhe e tretë, të ligjit nr. 29/2023, datë 30.03.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, si dhe shfuqizimi i pjesshëm i neneve 3, pika 5 dhe 12, pika 1, shkronja “ç”,*

të po këtij ligji, ku përfshihen edhe profesionet e kontabilistit, ekspertit kontabël, audituesit ligjor dhe avokatit, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimi i nenit 4 dhe tabelës analitike nr. 2 të vendimit nr. 753, datë 20.12.2023 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, ku përfshihen edhe profesionet e kontabilistit, ekspertit kontabël, audituesit ligjor dhe avokatit, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pezullimi i zbatimit të neneve 3, pika 5, 12, pika 1, shkronja “ç” dhe 69, pika 1, shkronja “dh”, fjalia e dytë dhe e tretë, të ligjit nr. 29/2023, datë 30.03.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, si dhe nenit 4 dhe tabelës analitike nr. 2 të vendimit nr. 753, datë 20.12.2023 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, ku përfshihen edhe profesionet e kontabilistit, ekspertit kontabël, audituesit ligjor dhe avokatit, derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi.”.

4. Në përfundim të shqyrtimit kushtetues, Gjykata, me vendimin nr. 52, datë 27.06.2024, ka disponuar: “Pranimin e pjesshëm të kërkesës. Shfuqizimin e nenit 69, pika 1, shkronja “dh”, fjalia e dytë dhe e tretë, të ligjit nr. 29/2023, datë 30.03.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Shfuqizimin e nenit 4 të vendimit nr. 753, datë 20.12.2023 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Rrëzimin e kërtimeve të tjera.”.

## II

### Pretendimet e kërkuarve

5. **Kërkuarët**, në mënyrë të përmbledhur, kanë kërkuar:

A. *Pezullimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore të kundërshtuara*

5.1. Pezullimin e zbatimit të dispozitave të kundërshtuara përfshirë edhe udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 08.09.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” të Ministrisë së Financave, pasi tatimi mbi të ardhurat për vitin 2024 i jep efektet retroaktive mbi fitimin e vitit 2023, kur ndërkohë në atë vit nuk ka pasur tatimfitim. Ndaj tyre kanë filluar efektet e drejtpërdrejta, duke i ngarkuar me këstet e tatimfitimit si parapagime, gjë e cila vë në rrezik mbarëvajtjen e bizneseve me aplikimin e gjobave për mospërbushje detyrimi.

B. *Për themelin e çështjes*

5.2. Shfuqizimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore, pasi ato cenojnë:

5.2.1. *Parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi ligjvënësi ka ngarkuar me tatimfitim “të vetëpunësuarit dhe entitetet” dhe

ka veçuar individët tregtarë duke mos pasur dhe justifikuar asnjë kriter objektiv. Ai nuk është mbështetur në konceptet e subjekteve dhe definicionet që i janë dhënë tregtarit dhe personit fizik profesionist i lirë i trajtuar edhe në ligje të tjera dhe më tej të justifikonte pabarazinë në tatime. Në asnjë raport, konsultim publik, të dhënash të të ardhurave nga profesionet e lira dhe debat në parlament nuk del arsyeja se përse shërbimet profesionale sipas listës së nxjerrë me VKM-në nr. 753/2023 do të duhet të tatonen në diferencim nga tregtarët/personat fizikë/entitetet që kryejnë aktivitete të tjera.

5.2.2. *Lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe të drejtën e ushtrimit të profesionit*, të garantuara nga nenet 11 dhe 49 të Kushtetutës, pasi legjislacioni tatimor dhe që sjell barrë fiskale prek drejtpërdrejt shtresën e mesme të shoqërisë, ku përfshihen profesionet e lira që ushtrojnë aktivitetin e tyre profesional në fusha të tilla si: avokatia, ekspert kontabël, auditues, përkthyes, IT, ndërmjetës e të tjerë, dhe që kanë filluar aktivitetin profesional pasi i janë nënshtruar rregullisht formimit të tyre, provimeve kualifikuese, marrjes së licencave, regjistrimit në dhomat dhe urdhrave përkatës. Për më tepër, pas vitit 2020 ka pasur rritje të regjistrimeve të tyre si subjekte në regjistrat e biznesit, si pasojë e premtimit elektoral për heqjen e tatimit mbi për të ardhurat për të gjithë bizneset me xhiro deri në vlerën 14 000 000 lekë, duke iu dhënë edhe një afat relativisht të gjatë deri në vitin 2029. Megjithatë, profesionet e lira kanë qenë dhe vijojnë të jenë pjesë e skemës së TVSH-së kur për çdo faturë që lëshojnë derdhin në organet tatimore masën 20%. Po kështu, liria ekonomike është cenuar edhe për shkak të fuqisë prapavepruese të ligjit, pasi lejon që për vitin 2024 të fillojë aplikimi i parapagimeve me logjikën e llogaritjes bazuar në deklarata të tatimit të thjeshtuar të viteve paraardhëse, gjë e cila bie ndesh me nenin 155 të Kushtetutës.

5.2.3. *Parimin e shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike, si dhe mbrojtjes së pritshmërisë së ligjshme*, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, pasi formulimi i dispozitave objekt kundërshtimi nuk plotëson kërkesat për qartësi dhe siguri, duke qenë konfuzë jo vetëm për personat ndaj të cilëve do të aplikohen, por edhe për vetë administratën tatimore. Jo pa qëllim në pikën 2 të nenit 4 të VKM-së nr. 753/2023 ligjvënësi ka parashikuar ndihmën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke i bërë dispozitat ligjore dhe nënligjore jo më të ligjshme por thjesht kalim diskrecional tek administrata tatimore që të vendosë rast pas rasti se ku hyn subjekti si përgjegjësi tatimore. Gjithashtu, ndërhyrja përveçse nuk është proporcionale dhe as objektivisht e motivuar krijon kaos normativ, pasi përplasat me parashikimet e ligjit për tregtarët dhe njëkohësisht prek të drejta të fituara, duke i ndryshuar

ato pa asnjë shkak të përligjur. Ai nuk përmban asnjë të referencë në lidhje me sa për qind mbledh të ardhura shteti nga kategoria e profesioneve të lira dhe përse duhet të ndërhynte me rritje të barrës fiskale. Ai nuk justifikohet aspak me ndonjë interes publik të qenësishëm, por me kërkesa të shtetit social, pasi ndonëse është e vërtetë që ajo favorizon bizneset e vogla familjare, cenon interesat ekonomikë të një grupi tjetër profesionistësh.

5.2.4. *Paragjykimin e hyrjes në profesionet e lira dhe rëndësinë e vazhdueshmërisë së profesioneve të rregulluara (ose jo)*, pasi krijon pengesa dhe nuk favorizon hyrjen në treg të profesionistëve të lirë. Ndikimi që do të ketë tatimi i të gjithë profesioneve të lira dhe pa asnjë shkallëzim edhe brenda kësaj kategorie të madhe do të sillte shtrembërim të tregut dhe nuk do të garantonte vijueshmërinë e tyre duke mbetur vetëm një rreth i ngushtë profesionistësh. Statistikat e ikjes në emigrim të një numri të lartë shqiptarësh vitet e fundit, kryesisht profesionistë të lirë, duhet të ishte kampanë alarmi për shtetin për të formuar politika në mbrojtje të kësaj kategorie dhe jo t'i godiste ata.

5.2.5. *Konkurrencën dhe ngritjen artificiale të çmimeve të shërbimeve*, pasi ngarkesa fiskale do të çojë detyrimisht në reduktimin e kërkesës për shërbime, në kalimin e shërbimeve në kanale jo zyrtare ose në rritjen në bllok të çmimeve të shërbimeve. Në të tria këto raste tregu i shërbimeve do të pësojë një përkeqësim i cili prek në mënyrë të drejtpërdrejtë jo vetëm profesionistët e lirë, por edhe konsumatorin final duke i ngarkuar një rritje çmimesh si pasojë e ngritjes së barrës fiskale. Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga INSTAT-i për vitet 2020, 2021 dhe 2022 konstatohet rritje e aktiviteteve ekonomike, juridike, auditimit, këshillimit, menaxhimit nga profesionistët e lirë, përkatësisht: IT, përkthyes, ekspert kontabël, ndërmjetës. Përkundrejt kësaj, nga dispozitat objekt kundërshtimi atyre u përkeqësohet trajtimi duke mos mbajtur parasysh që ky treg tashmë është i hapur edhe për profesionistët që vijnë nga vendet e Bashkimit Evropian, duke i ekspozuar shumë ndaj tyre.

### III

#### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

##### A. *Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës*

6. Gjykata ka vlerësuar juridiksionin e saj dhe legjitimimin e subjekteve, si aspekte kryesore që mundësojnë fillimin e procesit kushtetues, bazuar në nenet 131 dhe 134 të Kushtetutës, të lidhura me përmbajtjen e ligjit nr. 8577/2000. Kështu, sipas nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, ankimi

kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Për sa u takon rregullimeve të veçanta të shqyrtimit paraprak, ato përcaktohen nga neni 31/a, pika 2, i të njëjtit ligj dhe, në shtesë të kriterëve të tjera, kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës, legjitimitimin formal të kërkuarit dhe përfaqësuesit, si dhe me respektimin dhe vlerën e vendimmarrjeve të mëparshme të Gjykatës. Ky kriter i fundit përcaktohet nga shkronja “dh” e pikës 2 të nenit 31/a, sipas së cilës vendoset moskalimi i çështjes në seancë plenare kur kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës.

7. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuarit kanë kundërshtuar si antikushtetuese nenet 12, pika 1, 24, pika 2 dhe 69, pika 1, shkronjat “dh” dhe “ë”, të ligjit nr. 29/2023, si dhe nenin 4 të VKM-së nr. 753/2023, të cilat, sipas tyre, u kanë cenuar të drejtat dhe liritë kushtetuese në drejtim të parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe së drejtës së ushtrimit të profesionit, parimeve të shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike, si dhe mbrojtjes së pritshmërisë së ligjshme, paragjyqimit të hyrjes në profesionet e lira dhe rëndësisë së vazhdueshmërisë së profesioneve të rregulluara (ose jo), konkurrencës dhe ngritjes artificiale të çmimeve të shërbimeve. Sipas kërkuarëve, ligjvënësi ka diferencuar subjektet tregtare që ofrojnë shërbime profesionale në raport me subjektet e tjera pa marrë parasysh ndonjë kriter objektiv, megjithëse kanë të njëjtin nivel ardhurash të vjetore deri në 14 milionë lekë. Ndërhyrjet, kanë argumentuar kërkuarit, kanë shkelur kufijtë e lirisë së veprimtarisë ekonomike, sikurse rezultojnë edhe nga ashpërsia e masave që zbatohet ndaj tyre, të cilat nuk justifikojnë aspak interesin publik që propozuesi e lidh me riskun dhe deformimet që janë krijuar në sistemin tatimor nga shfrytëzimi i normës tatimore 0%. Sipas kërkuarëve, norma e tatimit mbi të ardhurat është dukshëm e ekzagjeruar dhe aspak e përshtatshme për të justifikuar arritjen e qëllimit dhe objektivit për të cilin ajo është parashikuar.

8. Mbledhja e Gjyqtarëve vë në dukje se Gjykata, me vendimin nr. 52, datë 27.06.2024, ka marrë në shqyrtim çështjen me objekt shfuqizimin e neneve 3, pika 5, 12, pika 1, shkronja “ç”, 24, pika 2 dhe 69, pika 1, shkronja “dh”, fjalia e dytë dhe e tretë, të ligjit nr. 29/2023, si dhe të nenit 4 dhe tabelës analitike nr. 2 të VKM-së nr. 753/2023. Në këtë vendim, Gjykata, mbështetur në thelbin e argumenteve se zbatimi i normës tatimore prej 15 % për të ardhurat vjetore deri në 14 milionë lekë, duke filluar nga data 1 janar 2024, vetëm ndaj një kategorie të caktuar tatimpaguesish, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 753/2023, e cila ka hyrë në fuqi vetëm pak ditë përpara se norma tatimore

të zbatohet, ka vendosur një barrë shpërpjesëtimore dhe se mjete i zgjedhur është i ashpër, jo i domosdoshëm dhe jo i përshtatshëm (*shih paragrafin 27 të vendimit*), ka çmuar të analizojë çështjen në drejtim të faktit nëse norma tatimore prej 15%, e parë e lidhur me kohën e zbatimit të saj dhe e zbatuar vetëm ndaj një kategorie të caktuar tatimpaguesish, plotëson kriteret e nenit 17 të Kushtetutës dhe përmbush pritshmëritë legjitime të subjekteve ndaj të cilave zbatohet në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike (*shih paragrafin 29 po aty*).

9. Në përfundim, Gjykata ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesës dhe ka shfuqizuar nenin 69, pika 1, shkronja “dh”, fjalia e dytë dhe e tretë, të ligjit nr. 29/2023, si dhe nenin 4 të VKM-së nr. 753/2023, duke arsyetuar se “*përcaktimi i një kalendari të ndryshëm për hyrjen në fuqi të detyrimit të ri tatimor për të vetëpunësuarit që furnizojnë shërbime profesionale në krahasim me të vetëpunësuarit që kryejnë veprimtari të mirëfilltë tregtare (duke rezervuar për këta të dytët një zgjidhje të butë me hyrjen në fuqi të normës së re tatimore në vitin fiskal 2030), i gërshetuar me masën e normës së re tatimore prej 15%, mungesën e një periudhe të përshtatshme njoftimi për subjektet mbi të cilat rëndon norma e re tatimore (ajo hyri në fuqi rreth 7 muaj nga miratimi i ligjit, ndërsa përcaktimi i llojit të aktiviteteve konkrete, të cilat do t’i nënshtroheshin normës të re tatimore duke filluar nga viti fiskal 2024, u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave vetëm 10 ditë përpara se të fillonte zbatimi i efekteve të ligjit), pa ndonjë lloj forme përshkallëzimi dhe pa u dhënë mundësinë e duhur subjekteve të përshtatshëm me masën e re të normës tatimore cenon parimin e proporcionalitetit në drejtim të domosdoshmërisë/ashpërsisë së mjetit të përzgjedhur nga ligjvënësi. Në këtë pikë Gjykata vë në dukje se zbatimi i ligjeve tatimore duhet të shoqërohet me masa të përshtatshme kalimtare, ndaj dhënia kohë tatimpaguesve u jep atyre mundësinë jo vetëm të njihen me formulat e llogaritjes së zbatimit të tatimit ndaj tyre, por edhe të marrin masa që vetë subjektet tatimpaguese i vlerësojnë të nevojshme për të përballuar pasojat e skemës së zbatueshme. Thënë kjo, edhe parimi i sigurisë juridike në vështrim të pritshmërive të ligjshme për shkak të kohës së kufizuar rezulton i cenuar. Në këtë situatë, Gjykata, duke mos vënë në dyshim hapësirën e gjerë dhe diskrecionin e ligjvënësit për të përcaktuar masën e normës tatimore për se (rasti konkret shifra 15%) dhe as faktin se përjashtimi nga detyrimet tatimore nuk përbën të drejtë të subjektit tatimpagues, vlerëson se nga analiza e ndërthurur e rrethanave në të cilat norma e re tatimore është miratuar dhe zbatuar, ajo nuk është proporcionale në drejtim të domosdoshmërisë, ndaj pretendimi i kërkuësve është i bazuar” (*shih paragrafin 51 të vendimit*).*

10. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se fakti që parapagimi për vitin 2024 do të përlogaritet mbi bazën e deklarimeve tatimore të vitit 2023, nuk lidhet me efektet prapavepruese të ligjit, por me mënyrën e funksionimit të sistemit fiskal, i cili bazohet në deklarimet tatimore të viteve të mëparshme.

Për më tepër, metodologjia e përlllogaritjes së tatimit bazuar në deklaratimet e viteve pararendëse është praktikë pune e pakundërshtuar ndër vite (*shih paragrafin 25, po aty*). Në konkluzion, Gjykata ka çmuar të panevojshëm shqyrtimin më vete të pretendimeve të tjera që lidheshin me cenimin e parimeve të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, si dhe të rezervës ligjore në fushën e tatimeve dhe hierarkisë së normave, si argumente mbështetëse të kërimit për kontrollin e kushtetutshmërisë së dispozitave objekt gjykimi (*shih paragrafin 53 të vendimit*).

11. Në kontekst të sa më sipër, rezulton se, në thelb, pretendimeve dhe argumenteve të kërkuësve u është dhënë përgjigje me vendimin nr. 52, datë 27.06.2024 të Gjykatës. Në këtë situatë, Mbledhja e Gjyqtarëve sjell në vëmendje jurisprudencën e Gjykatës, sipas së cilës, në të drejtën kushtetuese parimi *res judicata* njihet si një nga tre format e efekteve që merr vendimi gjyqësor në procedurën abstrakte të kontrollit të kushtetutshmërisë së normave juridike, e cila përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të tij, për sa u përket fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin ajo ka dhënë vendimin (*shih vendimet nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve, mbështetur në shkronjën “dh”, pika 2, të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuësit nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.